



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV-të
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 139/13
Prishtinë, më 18.12.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Muhamet Mustafa, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi, Duda Balje dhe Sevdije Lama.

Mungoi: Hykmete Bajrami.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli, Imba Rudaku (praktikante) dhe Arbëreshë Kosumi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj – Minster i Financave, Nenad Rasic – Ministrë i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agim Krasniqi – Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Petrit Popova – Departamenti i Buxhetit Lokal në MF, Qerkin Berisha nga MF, Eshref Shabani – Sekretar në MPMS, Ramadan Islami he Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Haxhi Gashi nga USAID.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Rishqyrtimi i vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat më tarif zero të tatimit doganor;
3. Rishqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë;
4. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropian lidhur me Projektligjin nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës, Viktimave Civile dhe Familiarëve të tyre me amendamente e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës me amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Rishqyrtimi i vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat më tarif zero të tatimit doganor

Kryetarja theksojë ligji është miratuara nga Kuvendi pothuajse para një viti, por është kthyer nga Presidentja me vërejtjet. Unë bashkarisht me nënkryetarin e komisionit dhe disa ekspert kemi punuar dhe kemi bërë një propozim të ri dhe shpresojmë se komisioni do ta përkrah dhe do të gjejme mirëkuptim edhe nga komisioni për legjislacion. Propozimi është që nenin 3 të ndryshohet dhe të thuhet: 1. Subjektet dhe mallrat e liruar nga tatimi doganor apo reduktimi ose pezullimi i tatimit doganor në zero normë, rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe për këtë njoftohet Kuvendi dhe Lirimet fillestare janë të përcaktuara në Pjesën A, B, C dhe D të Aneksit 1 (një), bashkangjitur këtij ligji. Ndërkaq neni 4 të hiqet. Siç e dijmë me nënshkrimin e marrëveshjes së asociim-stabilizimit, ky ligj do të humbë efektin e tij, pas që do të kemi lirimet doganore, por se deri në atë kohë ne po vështrojmë punën e bizneseve, sepse nuk po mund të përfitojnë nga lirimet doganore që garaton ky ligj.

Muhamet Mustafa ka klauar një kohë që kur është miratuar ky ligj në Kuvend. Qfarë ndryshon propozimi i tashmë nga ajo që ka qenë në ligj.

Naser Osmani sqaroi se ngërqi procedural ka filluar, kur ministria e financave pas konsultimit me komisionin mundet me u ba ndërhyrjet në ligj. Komisioni për legjislacion ka thënë kuart se nuk mundet me ba askush ndryshim në ligj, për arsye se ajo duhet të kalojë në procedura të rregullta për plotësimin edhe ndryshimin e ligjit. Afatet për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve janë shumë të gjata dhe kjo qështje në këtë ligj nuk iu ndihmon bizneseve dhe kjo ndikon që mos të jemi konkurrent me shtetet që na rrethojnë. Zgjidhja e re është që Qeveria dhe jo ministria me akt nënligjor të mund të bëjë ndryshimet në ankesin e ligjit, por se duhet informuar parlamentin dhe nëse parlamenti e vëren se nuk është diçka në rregull krijon debat dhe bëhet një presioni qeverisë.

Muhamet Mustafa pyeti ministrin a parashihi me u ba shumë ndryshime në ankesin e ligjit dhe pas po paraqitet ky problem?

Besim Beqaj sqaroi se ideja fillestare e propozim ligjit ka qenë që Qeveria të nxjerr një vendim konform gjendjes aktuale në konsultim me komisionin për buxhet e financat, sikur se ka qenë në disa ligje që janë në funksion e sipër. Unë kam then publikisht presidenca ka bërë gabim që ka kthyer ligjin, sepse se ka kontrolluar situatën qfarë është hyrë në atë automatizmin burokratik të kthimit të

ligjeve. Aryseja pse kemi propozuar kështu është për përshpejtimin e procedurave që mos të humbim ndoshta gjashtë muaj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit dhe ne nuk mund të iu përgjigjemi momenteve të kohës dhe interesave të biznesve. Qeveri miraton aktet nënligjore respektivisht edhe miraton listat dhe për këtë njoftohet kuvendi që mund të kërkojë shpjegime për ndryshimet e mundshme.

Alban Fetoshi thekson se nuk qëndron arsyetimi i ministrit se 6 muaj na merrë kohë plotësim dhe ndryshimi i ligjit sepse ne kemi pasur shumë ligje tjera të cilat kemi i kaluar brenda 2 apo 3 ditësh, dhe nëse vlerësohet e nevojshme edhe këtë ligj si Kuvend e kish ndryshue me proceduar më të përshpejtuar. Arsyeja pse është kundërshtuar neni 4 është se aneksi është pjesë e ligjit dhe në këtë rast është pjesa kryesore e ligjit dhe vetëm Kuvendi mund të ndryshojë ligjet. Kjo siç është propozuar është e papranueshme dhe jam kundër.

Muhamet Mustafa në qoftë se ne fillojmë me i ndërrue nomrat për intersa të një fabrike në tjetrën, unë mendoj se kjo nuk është ajo që na duhet dhe dëshirojmë. Ne duhet të ikim nga ndryshimi ad hoc i ligjeve dhe nuk e kuptojë se a është bërë një studim për mallra e liruara me aneks. Do të duhej të bëhen analiza për masta e propozuara, të procedohen në Kuvend dhe pastaj të votohen. Ne duhet me shkue me masa horizontale, paisjet duhet me u krye për import dhe eksport dhe janë kushtet e barabarta në treg për këtë qëllim, ndërkaq të ardhura e buxhetit, takimet i cakton Kuvendi.

Besim Beqaj kuvendi mund të vendos si dëshiron, por mendoj se forma siç është propozuar është në harmoni me praktikën e shteteve të ballkanit dhe të evropës. Për ministrin e financave procedura e gjatë është komplikim dhe nëse ju mendoni se duhet me iu komplikue jetën biznesve, nuk ka problem ne i zbatojmë liget, por mendojë që kjo nuk është e arsyeshme dhe në interes të ekonomisë dhe bizneseve.

Muhamet Mustafa ne po flasim për fakte dhe nëse ju mendoni si minisri që keni argumente e përvoja të mira për ndryshimin e tarifave dognore në vendet tjera, ju lutem na prezentoni këtu përvojat e mira që i keni. Nuk ka këtu kurfar rektorike këtu duhet të ipen argumente që ti krijohet një sistem sepse bizneset e kanë të parashikuar mjedisin edhe gjithçka dhe nëse i jepim të drejt qeveris me e hjek taksat ajo do me thën se mundeni me i rrit edhe me i zvoglu kjo është pasiguri e madhe .

Naser Osmani thekson se unë jom në përzgjedhje të praktikës në ekonominë e kosovës dhe çfardo forme jam kundër asaj që dilet nga institucionet. Unë jam për zgjidhjet praktike që e ndihmonë ekonomin e kosovës dhe ne duhet me qenë në hap të zhvillimit ekonomik. Në një takim që kishim me bizneset, në një shembull i prodhuesit vendor që prodhon paracetamollin që është paraparë të lirohet nga dogana me këtë ligj argumentohet se për lëndën e parë që duhet me e prodhue paracetamolli paguj doganë, kurse tjerët e sjellin pa doganë dhe shteti në këtë rast po më bënë konrruent. Prandja jam me u ndryshue dhe me qenë sa më praktike.

Muhamet Mustafa theksoi se nuk ka dëshirë të kuptohet se po kundërshtohet ligji, ne po përkrahim aneskin dhe unë votojë i pari dhe kamë kërkuar që duhet të përkrahen bizneset dhe do të ketë lirime doganore si në shumë vende, por ajo që po diskutojë është qështje më parimore .

Kryetarja ju e dini se në seancë është kërkuar debat pikërisht për këtë qështje dhe kemi thënë se ligji është në procedurë dhe do të kalojë shumë shpejt, por ka mbetur i bllokuar, Ne jemi përballur me bizneset në një takim që ka organizuar Oda Ekonomike Amerikane. Është a pa logjikshme ligji edhe

mëtutje të mbete kështu. Ne kemi angazhuar edhe një ekspert për të analizuar dokumentacionin e BE-së dhe në bazë të praktikave të vendeve tjera kemi ardhur deri të propozimi i fundit që do ta bllokonte miratimin e këtij ligji. Kërkojë mirëkuptimin e anëtarëve të komisionit të përkrahin këto propozim amendamente që janë në favor të biznesve deri sa të jemi pjesë e marrëveshjes së stabilizim-asociimit dhe të ecim përpara.

Alban Fetoshi qdo arsyetim që po jepet se Kuvendi e ka bllokuar ligjin nuk qendron, pasi që qeveria dhe Kuvendi në këtë rast kanë mendime të kundërta. Kuvendi qëndron prapa asaj që qdo ndryshim dhe plotësim i ligjeve duhet të bëhet sipas procedurës ligjore dhe jo përmes akteve nënligjore nga qeveria. Me këto amendamente që po propozohen nuk kemi ndryshime në përmbajtja dhe është e palogjikshme të përkrahet.

Naser Osmani njoftoi se kam marrë një përgjigje nga deputetja Hykmete Bajrami se tërhiqet nga propozim-amendamenti i saj që ka bërë për këtë ligj, më heret.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisionit me tetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Sevdije Lama), dy kundër (Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi) dhe ansjë Abstenim, nxori këtë

REKOMANDIM

- I. Të miratohen amendamentet e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa në Ligjin Nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 3 ndryshohet si vijon:

Neni 3

Lirimet e mallrave nga Tatimi Doganor

1. Subjektet dhe mallrat e liruar nga tatimi doganor apo reduktimi ose pezullimi i tatimit doganor në zero normë, rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe për këtë njoftohet Kuvendi.
2. Lirimet fillestare janë të përcaktuara në Pjesën A, B, C dhe D të Aneksit 1 (një), bashkangjitur këtij ligji.

Amendamenti 2

Neni 4, hiqet

3. Rishqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Kryetarja sqaroi se edhe te ky projektligj është e njëjta situatë, prandaj së bashku me nënkryetari dhe me përkrahjen e ekspertëve, kemi propozuar tri amendamente që i keni përpara.

Pas sqarimeve dhe propozimeve, me nëntë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Sevdije Lama), një kundër (Albana Fetoshi) dhe ansjë Abstenim, nxori këtë

REKOMANDIM

- I. I rekomandohet Kuvetit të miratojë amendament për Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 2, në paragrafin 1, 2 dhe 3, fjalët “të këtij Ligji”, zëvendësohen me fjalët “të bashkangjitur këtij ligji”.

Amendament 3

Neni 3, në paragrafin 2, fjalët “të këtij Ligji”, zëvendësohet me fjalët “të bashkangjitur këtij ligji”

Amendament 4

Neni 4, ndryshohet si në vijim:

Neni 4

Ndryshimi dhe plotësimi i Shtojcës

1. Në raste të veçanta Qeveria e Republikës së Kosovës me akt nënligjor, mund të ndryshon listën e produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë që i nënshtrohen tarifave të veçanta të akcizës dhe për këtë njoftohet Kuvendi.
 2. Lista fillestare e produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë janë të përcaktuara në Shtojcën A dhe B, bashkangjitur këtij ligji.
- II. Raporti final me amendamente për Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.
4. **Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropian lidhur me Projektligjin nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti**

Kryetarja komisioni ka shqyrtuar këtë pikë në një takim dhe si përfundim është shtyer dhe kemi kërkuar informata nga ministria e financave dhe ministria e punës dhe mirëqenies sociale. Në ndërkohë kemi pranuar edhe një shkresë nga FMN që kanë sugjeruar të mos pranohen rekomandimet si të tilla se bien në ndesh me marrëveshjen që ka FMN me qeverinë e Kosovës. Komisioni funksional nuk i ka përkrahur rekomandimet e këtyre dy komisioneve të përhershme.

Nenad Rasic ne kemi biseduar me komisionin për shëndetës dhe kemi pranuar letër edhe nga FMN se ky stazh që ka qenë i kontestueshëm gjatp vitit 1989 1999 ka qenë i paraparë dhe se pas miratimit të ligjit fillon procedura për indentifikimin të atyre njerzve të cilet që janë larguar me dhunë nga puna gjatë asaj periudhe. Prandaj duhet nje ekip të bëjë kategorizimin sepse duhet ti bazojmë në fakte reale, duke dhënë një afat për aplikim për ata persona që janë larguar me dhunë nga puna dhe pastaj të llogaritet kostoja buxhetore. Ne nuk guxojmë të miratojmë diqka që nuk dihet se sa do të kushtojë dhe do të kemi problem me FMN.

Besim Beqaj ne vlerësojmë se të gjitha propozimet që janë bërë deri më tani, të harmonizohen mbi bazën ndaj të cilit është bërë vlerësimi i koston buxhetore të projektligjit. Të mos miratohen ligjet që kanë problem të zbatohen, që kanë kosto të lartë dhe të paparashikuar.

Naser Osmani theksoi përveq kategorive të përcaktuar me këtë projektligj, do të duhej t'iu njihet kjo e drejtë e stazhit edhe kategorive tjera të viteve 90-ta që kanë dhënë kontribut për Kosovën dhe kanë punuar në kushte dhe rrethana shumë të vështira dhe për këto ekzistojnë shënimet. Jam kundër propozimeve joparimore dhe do të bëjë përpjekje që kjo e drejtë t'iu njihet edhe në seancë. Efekti i kësaj është edhe ekonomik, se për ata që shkojnë në pension, krijohen vende të reja të punës.

Nenad Rasic teknikisht na duhet një periudhë prej 6 deri 8 muaj të identifikohen e përfituesve. Meqë nuk e dijmë numrin dhe nuk mund të konstatojmë koston e zbatimit të ligjit.

Muhamet Mustafa përgjegjësi e jona është kur marrim vendimet për ngarkesa buxhetore ne duhet të dim se qka është ajo. Në anën tjetër nuk e kuptojë pse nuk kemi qenë në gjendje këtë, kur e dijmë se Kuvendi ka miruar rezolutën që punëtorëve të arsimit t'iu njihet stazhi. Kur Kuvendi nxjerr një rezolutë, qeveria është e obliguar të fillojë proceduat për hartimin e projektligjit ose të thuhet në Kuvend se nuk ka mundësi. Këto gjëra nuk bëhen në këtë mënyrë, duhet me qenë më të sigurtë me njerëzit, të thuhet se ka mundësi apo nuk ka dhe jo me ngarkue buxhetin me këto faktura sociale e në fund nuk mundemi me dal para këtyre kategorive. Duhet analizuar skemat sociale për të parë se kush vërteton e meriton të përfitojë. Ministria e financave ka thënë se ka kërkuar një auditim të skemave sociale dhe që menoj se duhet të bëhet dhe punë ndonjëherë pos shkojnë në mënyrë jo serioze.

Latif Gashi qështja për këtë projektligj është shumë më tepër e komplikuar se sa ne që mendojmë ne. Për aq sa kemi informacione disa proceduar në terren kanë filluar dhe janë shpërndarë formularët për punëtorët e arsimit që duhet treguar periudha kohore saktësisht ku kanë qenë në kohën 1989/99. Kemi shumë punëtor që kanë me kërkuar me marrë pensionin dhe ndoshta vullnetarisht e kanë lënë vendin në atë kohë. Prandja është e nevojshem të zhvillohen procedurat dhe të verifikohen përfituesit. Ministrinë përktëse duhet të jenë më të shpejte në punën e tyre, në mënyrë që të kemi një kosto përfundimtare dhe të dihet numri i saktë i përfituesve. Nuk jam të miratojmë ligj, pa ditur numrin e saktë të njerzve që do të gëzojnë këto beneficione.

Xhevdet Neziraj ne duhet të jemi të kujdesshëm me skemat sociale sepse nëse diqka rrezikon buxhetin janë këto skema. Ne jemi deputetë dhe bëjmë politikë, por duhet të jemi të kujdesshëm kur marrim vendimi sepse pastaj po kemi problem në realizimin e asaj qfarë është premtuar. Ende për veteranët e luftës, as të burgoosurit politikë as punëtorët të arsimit nuk kemi ende shifra të sakta dhe po na dalin numra vazhdimisht. Jam për atë që të jemi syqel në këtë drejtim dhe të merret vendimi i

duhur.

Alban Fetoshi pyeti a ka filluar ministria procedurat për verifikimin e mësimdhënësve, pasi që dëgjova se tashmë janë shpërndarë disa formular për aplikim për ata që do të përfitojnë?

Nenad Rasic theksoi se ministria e arsimit ka shpërndarë ato formularë, pasi që ata do të kenë më së shumti aplikantë. Në projektligj është një nen, që thotë se ministria punës pas miratimit të ligjit, merr masat për mundësinë për aplikantët. Ne kemi shkurtuar afatin në 9 muaj për aplikim për atë që kanë drejtë për aplikim që t'iu njihet stazhi dhe atë që janë pjesë e kategorizimit.

Alban Fetoshi qeveria është ajo që duhet të merret me këto politika sociale edhe ti ketë parasysh se gjatë miratimit të buxhetit, sepse është e vetmja kategori që nuk merret seriozisht. Me ndarjet buxhetore është dashur ti kushtohet prioritet, për shkak se herë që po kemi të bëjmë me këtë kategori, po thuhet se nuk kemi buxhet dhe kjo po na përseritet në çdo ligj dhe kjo është joserioze. Pyeti kur bëhen ndarjet buxhetore në ministrin e financave, a i dërgoni kërkesat ju si ministri e punës gjatë kësaj kohe apo janë politika qeveritare, si është puna në këtë drejtim?

Nenad Rasic në janar bëhen një vit në bisedime me ministrinë e financave dhe kemi deabta të gjëra për kpto qështje. Unë e kuptoj qëndrimin e ministrinë e financave sepse ka punë me secilën ministri, mirëpo për ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale ka të bëjë me kategori të ndishme dhe duhet të kemi prioritet më të madh dhe kërkesat tona janë të arsyeshme.

Latif Gashi unë mendojë se është e nevojshë të thrrasim në takim komisionin për verifikimin e veteranëve të luftës dhe marrim informacione se deri ku ka shkue verifikimi. Po ashtu të diskutojmë me ministrinë e arsimit për të parë verifikimin e aplikantëve që duhet ti gëzojnë këto skema pensionale. Pa pasur këto informacione nuk mund të nxjerrim ligje.

Agim Krasniqi ministri i dha sqarimet dhe qëndrimet e ministrisë së financave dhe mendojë që duhet të mbetet siç e kemi bërë ne koston financiare, përndryshe qështja e verifikimit dhe vlerësimit financiar do të ishte shumë e vështirë të përcaktohet dhe problematike për buxhetin e Kosovës dhe për zbatimin e vet ligjeve.

Haxhi Gashi sqaroi se me këtë propozim, iu njihet e drejta afirmative përfituesve, por se implikimet buxhetore nuk mund të përcaktohen tani me këtë ligj. Kushtet dhe kriteret dhe kostoja buxhetore përcaktohen me akt tjerë ligjor apo nënligjor që është kriteri moshës, periudhës së punës.

Muhamet Mustafa do të duhej që kriteret të përcaktoheshin me ligj apo të precizohet që akti nënligjor të nxjerret brenda tre muajsh.

Qerkin Berisha nëse ndryshohet periudha 15 vite, ne rrezikojmë marrëveshjen me FMN dhe kostoja do të ishte e paparashikuar dhe e papërbalueshme. Nuk mund dikujt me akt ligjor e dikujt tjetër me akt nënligjor t'iu njihet e drejta.

Agim Krasniqi duhet të pasur kujdes si trajtohen kërkesat për zgjerimin e skemave sociale sespe buxheti nuk lejon shumë hapësirë dhe do të përballemi edhe me disa ligje tjera të kësaj natyre. Nuk duhet aporvuvar kërkesa pa pasur një vlerësim të një kosto të mirëfilltë financiare.

Latif Gashi pa pasur një bazë ligjore nuk mund të fillohet me procedurë të verifikimit. Ajo që është propozuar tani ka të bëjë me atë që t'iu njihet e drejta e pensionit punëtorëve të larguar me dhunë nga puna, ndërsa me akte tjera të veqanta ligjore të përcaktohen kushtet dhe kriteret e përfitimit, pasi që të bëhet edhe vlerësimi i saktë i kostos financiare identifikimi i përfituesve.

Albana Fetoshi pajtohem që me këtë ligj t'iu njihet e drejta dhe propozojë të përcaktohet afati për nxjerrjen e aktit nënligjor për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të përfituesve.

Eshref Shabani të keni kujdes dhe përgjegjësi me këto vendime. Ne kemi problem me skemat sociale me përmbyllë vitin.

Kryetarja do të duhej që në komisionin funksional të jepen sqarimet, sepse të gjitha ngarkesat shtesë buxhetore i ka bërë komisioni funksional dhe na ka vënë në një pozitë shumë të palakmueshme si komision për buxhet dhe financa. Ne duhet gjërat të rregullojmë dhe fusim në sistem.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni nxori këto

Rekomandime

- I. Me dy vota Abstenime (Naser Osmani dhe Muhamet Mustafa), Një Për (Albana Fetoshi) dhe shtatë Kundër (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Sevdije Lama), Komisioni për Buxhet dhe Financa vlerësoi se amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- II. Me një votë Për (Naser Osman), një Abstenim (Muhamet Mustafa), dhe tetë Kundër Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Sevdije Lama), Komisioni për Buxhet dhe Financa vlerësoi se amendamenti i Komisionit për Integritet Evropian përmban implikime buxhetore shtesë.
- III. Me një votë Kundër (Naser Osman), një Abstenim (Xhevdet Neziraj), dhe tetë Kundër Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa, Duda Balje dhe Sevdije Lama), Komisioni për Buxhet dhe Financa propozon amendament në Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti:

Në nenin 8, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri si vijon :

“E drejta në pension ju njihet punëtorëve të arsimit dhe punëtorëve tjerë të larguar me dhunë nga puna. E drejta dhe përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pension kontributpagues të moshës për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna, apo të shpallur si tepërc teknologjike pa bazë ligjore, në vitet 1989 deri 1999, do të rregullohet me akt të veçantë ligjor”.

- IV. Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që amendamenti 7 i komisionit funksional, të hiqet.

5. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre me amendamente e Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale**

Kryetarja sqaroi se si komisioni i kemi dhënë një rekomandim para leximit të parë në Kuvend ku kemi thënë se projektligji përmban kosto buxhetore shtesë, dhe nuk është paraparë dhe vlerësuar kostoja fare as në KASH. Kuvendi e ka miratuar projektligjin në parim dhe komisioni funksional ka bërë amendamentimin e projektligjit. Komisioni funksional ka bërë disa ndryshime edhe në ligjin bazik që në faktë nuk është e lejueshme të ndërhyhet dhe nenet që janë shtuar kanë kosto të papërcaktuar buxhetore dhe nuk e kuptojë pse nuk ka reaguar komision për legjislacion. Rekomandimet e FMN-së janë se ky projektligj është në kundërshtim me marrëveshjen me qeverinë.

Muhamet Mustafa ne kemi hyrë në një rrugë pa krye, duhet të shqyrtojmë problemin në esencë. Duhet ngarkuar ministria e financave, ministrinë e punës, ndoshta të angazhohet edhe ndonjë organizatë adekuate që të analizohet krejt pakoja sociale. Ne po i shtyjmë problemet në vitet në vazhdim, por ato na kthehen prapë. Ne kemi përgjegjësi, si Kuvend dhe si qeveri dhe të jemi të sinqertë me njerzit tonë dhe të sqarojmë se kaq është buxheti e kaq kemi mundësi iu kemi adresue problemet atyre që kanë më së shumt nevojë.

Kryetarja propozon që të formohet një grup punues që do të merret më në detale me këtë projektligj, amendamentet e propozuara dhe vërejtjet që kanë ardhur edhe nga FMN dhe të ftohen të gjithë palët relevante.

Latif Gashi përkrau kërkesën për grup punues, por paraprakisht nuk do të duhej të thuhet se për këto kategori është mungesa e buxhetit. Ne kemi mundur që ti dalim shumë projekte, po që se komisionet përkatëse do ta kishin kryer detyrën e vetë, por ne si Kuvend nuk kemi bërë asnjëherë presion te komisionit qeveritar apo shoqatat përkatëse që na akuzojnë neve e ne si kemi thirrur në përgjegjësi për ti pyetur se pse që 15 vite nuk e keni kryer këtë detyrë. Mendojë se duhe thirrur shoqatat në dëgjim e më kërkue përgjegjësi për numrin e saktë të veteranëve të luftës dhe përfituesve me këtë ligj, pasi që e kanë rritur numrin e përfituesve.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njzëri nxori këtë

Përfundim

Caktohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familiarëve të tyre me amendamente e Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në përbërje: Safete Hadergjonaj (kryesues), Naser Osmani, Latif Gashi, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj. Grupi punues në afatin më të shpejtë paraqet raportin me rekomandime për miratim në Komision.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës me amendamentet e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri m për

Kryetarja theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk prodhon kosto buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës dhe amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

7. Të ndryshme

7.1. Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit, se komisionet tjera të përhershme, e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni dhe nuk kanë bërë ndonjë vërejtje. Ne me datë të sotme, do të dorëzojmë Raportin final me amendamente për shqyrtim dhe miratim në Senacë plenare.

7.2. Kryetarja theksoi se si komision me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për lojërat e fatit, ndër tjera si komision kemi rekomanduar se do të marrim iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. Prandaj propozoj që të caktohet një grup punues dhe në grup të jenë anëtarët që kanë marrë pjesë në monitorimin e ligjit.

Komisioni njëzëri caktoi grupin punues për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lojërat e Fatit, me këtë përbrëje: Naser Osmani (kryesues), Muhamet Mustafa, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

7.3. Kryetarja propozoi të caktohet edhe një grup punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik që është miratuar në lexim të parë në Kuvend, me këtë përbrëje: Latif Gashi (kryesues), Sevdije Lama, Alban Fetoshi, Jelena Bontic dhe Xhevdet Njeziraj .

Mbledhja përfundoi: 13:00.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj